

## **AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR** **“Royal Qlt.” sh.p.k**

Sot më datë 01.07.2021, në Tiranë, me cilësinë e “ortakut themelues”: Z. Geri Nano, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me numër Personal J20908051G, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, me vullnet të plotë dhe të lirë, vendos krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“Royal Qlt.”** sh.p.k. e cila ushtron veprimtarinë e saj mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë si më poshtë:

### **KREU I** **FORMA LIGJORE, SELIA,**

#### **Neni 1**

##### **Forma ligjore e shoqërisë**

1.1. Shoqëria **“Royal Qlt.”** sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

#### **Neni 2**

##### **Personaliteti juridik**

- 2.1. Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
- 2.2. Shoqëria **“Royal Qlt.”** sh.p.k., është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortakët e shoqërisë”, të cilët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.
- 2.3. Ortakët gëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kanë dhënë në kapital.

#### **Neni 3**

##### **Kohëzgjatja**

3.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

#### **Neni 4**

##### **Selia**

4.1. Shoqëria e ka selinë kryesore në Njësinë Administrative Nr.3, Rruga “Sitki Çiço”, Pallati nr.12/1, Tiranë, zona kadastrale nr.8140.

4.2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## **Neni 5**

### **Objekti i veprimtarisë**

5.1. Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në përputhje me legjislacionin shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht, në:

- a) Ndërtim, restaurim, mirëmbajtje, kontrollimin, menaxhimin e objekteve civile, industriale, turistike, bujqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërtimin e rrugëve, autostradave, shkollave civile dhe ekonomike, asfaltim rrugësh, punime mirëmbajtjeje, mbikëqyrje, kolaudim, sinjalistikë etj. Ndërtimin, restaurim, mirëmbajtje, kontrollimin, menaxhimin i objekteve private dhe publike, duke përfshirë të gjitha llojet e punimeve të ndërtimeve, projektme, instalime, gërmime dheu etj. Ndërtim, ujësjellës-kanalizime, kanale, impiante vaditëse. Përfundime themeli e punime nëntokësore. Izolime mbi dhe nëntokësore nga ujerat. Ndërtim rrugësh dhe urash si dhe ndërtime portuale, detare dhe ajrore si dhe rikonstruksionin e tyre, asfaltim dhe veshje me asfaltim, ndërtim digash, galeri, tunele, ndërtimi i veprave të kullimit, ujitje, impiante vaditëse, punime mbrojtje dhe sisteme hidraulike, punime dhe sisteme elektrike. Ndërtim ambiente dhe sisteme gjelbërimi, parqe e lulishte, si dhe çdo ndërtim të llojeve të ndryshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- b) Prodhim, tregtimi import-eksport dhe shitje me shumicë dhe pakicë e materialeve të ndërtimit dhe mallrave të ndryshëm industrialë. Prodhim dhe tregtim të fidaneve dhe farave bujqësore në Republikën e Shqipërisë. Grumbullim dhe transportim mbetje jo të rrezikshme. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme. Shërbime të ndryshme në sferën e ndërtimit, si punë karpentierie, shtrime pllakash e parketesh, muratorë, hekurkthyes, punime elektrike, hidraulike, gipsi, etj., prodhim-zhvillim, import export dhe tregti të pajisjeve dhe programeve në fushën e teknologjisë së Informacionit. Konsulencë dhe mirëmbajtjeve të tyre. Krijim, organizim kurse profesionale, trajnime etj. Operim, zbatim, dhenie me qera e sistemeve dhe e pajisjeve të ndryshme informatike që shërbejnë për administrimin e operacioneve të ndërmarrjeve, shitje në internet, sisteme të parkimit, sisteme biletarie elektronike dhe të ngjashme. Tregtim me pakicë e shumicë të artikujve industriale, veshje dhe import eksportin e tyre. Veprimtari prodhimi dhe tregtimi që lidhen me veprimtari mekanike, elektromekanike, elektronike, kimike, bujqësi, mobilim, turizëm, ndërtim, trajtim ujor, ekologji, sport dhe produkte të tjera të lidhura me to ose plotësuese, si dhe blerje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditimi dhe administrimi, si dhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, dege ndërmarrjesh, si edhe të këtë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri e në koncesione, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me objektin e vet, apo gjithësi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.
- c) Ofrimin e Konsulencës ligjore dhe juridike për çështje të ndryshme. Shërbime përfaqësimi ndaj shoqërive tregtare, individëve, tregtareve, qofshin këta vendas apo të

huaj, ofrimin e shërbimeve të marketingut ndaj subjekteve të ndryshëm etj. Përfaqësime në organet e administratës publike, gjykatat e çdo niveli, gjykata arbitrazhi brenda dhe jashtë vendit, zyra noteriale, ente private. Konsulentë në fushën e ndërtimit, projektimit, ekonomisë etj.. Ofrimin e shërbimeve në fushën e turizmit, dhënie-marrje ambientesh me qira. Bar-kafe, pastičeri, restorant etj.. Organizimit të eventeve dhe festave të ndryshme si dasma, ditëlindje, konferenca, reklama, trajnime, realizime foto, video etj. Zhvillimin e aktiviteteve sportive, palestere, fitnes, spa, etj.

Vlerësimi i pasurive të paluajtshme të çdo lloji: truall, ndërtesa civile dhe industriale, toka bujqësore, ara, pyje, kullota, livadhe etj. Hartimin e raporteve të vlerësimit të pasurive të paluajtshme për Bankat e nivelit të dytë, Fonde Investimi, persona fizik dhe juridik. Vlerësimin e pasurive që përbëjnë vlerë financiare. Kryerja e operacioneve ekonomike e juridike, industriale, prodhuese, tregtare që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, brenda kuadrit të dispozitave ligjore për realizimin e çdo biznesi të përshtatshëm në arritjen e qëllimit të shoqërisë;

d) Transport mallrash dhe njerëzish brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

e) Në përputhje me legjislacionin në fuqi, ofrimin e shërbimit për Ruajtjen e objekteve dhe institucioneve publike dhe private, sigurimin fizik, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të shtetësive vendas dhe të huaj, instalim dhe përdorim i sinjalistikës të radio alarmit dhe pajisjeve të tjera të vëzhgimit. Prodhim mirëmbajtje dhe tregtim i pajisjeve dhe lendeve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit. Projektim dhe instalim i kontrollit të aksesit dhe të sigurisë së lartë, integrim i sistemeve. Projektim, furnizim, instalim dhe mirëmbajtje e sistemeve për prodhimin e energjisë alternative (fotovoltaike, wind etj). Konsulencë dhe analize të sigurisë Projektim, furnizim, instalim dhe mirëmbajtja e sistemeve të inteligjencës. Projektim, zbatim dhe mirëmbajtje të sistemeve dhe monitorimi i sistemeve të shuarjes së zjarrit. Projektim dhe instalim i pajisjeve dhe impianteve elektrike e civile. Furnizim, instalim, mirëmbajtje i pajisjeve elektronike për përdorim detare. Furnizim, instalim dhe mirëmbajtje i pajisjeve të telekomunikacionit dhe radio ndërlidhjes. Importe-eksporte dhe shitje, ndërtim dhe mirëmbajtje e avionëve dhe pjesëve të tyre, detektive dhe investigues privat. Qendër trajnimit privat për punonjësit e SHPSF dhe atyre që me ligj i njihet e drejta e trajnimit strukturat ligj zbatuese. Shërbime të ruajtjes, transportit e shoqërimit të vlerave monetare e sendeve të çmuara.

5.2. Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji, lidhur apo ndihmës me qëllim të përmbushës ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektivit të saj.

## **KREU II KAPITALI**

### **Neni 6 Kapitali themeltar**

#### **Kapitali themeltar**

6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) lekë, i zotëruar nga ortakët si më poshtë:

**Z.Geri Nano**, zotërues i 1 kuote, që përfaqësojnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 10 000 lekë.

6.2. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme.

6.3. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

6.4. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat, që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

#### **Neni 7**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

7.1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.

7.2. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakëve me të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

7.3. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 8**

##### **Transferimi i kapitalit**

8.1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

8.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

### **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 9**

##### **Organi Vendimmarrës**

9.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

9.2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;

- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - f) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 9.3. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 9.4. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 9.5. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **Neni 10**

### **Administrimi**

- 10.1. Administrator i shoqërisë është **Z. Geri NANO**.
- 10.2. Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.
- 10.3. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë.
- 10.4. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

## **Neni 11**

### **Kompetencat**

- 11.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

- g) Administratori ne respekt te dispozitive ligjore, mund te kryeje te gjitha operacionet qe do te jne te konsideruara nga administratori te nevojshme dhe te dobishmeper te arritur objektivat sociale aty perfshire leshimin e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave te trete.
  - h) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- 11.2. Administratori eshte i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur:
- a) Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
  - b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
- 11.3. Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.
- 11.4. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.
- 11.5. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.
- 11.6. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.
- 11.7. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## **Neni 12**

### **Viti Financiar**

- 12.1. Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## **Neni 13**

### **Bilanci i shoqërisë dhe dividendet**

- 13.1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.
- 13.2. Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

**Neni 14**

**Baza Ligjore**

- 14.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 14.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 15**

**Dispozita përfundimtare**

- 15.1. Ky Akt themelimi i shoqërisë "Royal Qlt." sh.p.k, u redaktua nga unë "ortakët themelues" në 4 kopje me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

**ORTAKËT E SHOQËRISË**

**"Royal Qlt." sh.p.k**

**Geri NANO**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Geri NANO', is written over a horizontal line. The signature is stylized and somewhat cursive.

**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Royal Qlt.” sh.p.k**

Sot më datë 01.07.2021, në Tiranë, me cilësinë e “ortakut themelues”: Z. Geri Nano, madhor dhe me zotësi juridike dhe për të vepruar, me vullnet të plotë dhe të lirë, hartojmë këtë statut të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin **“Royal Qlt.” sh.p.k**

**Neni 1**

**Forma ligjore e shoqërisë**

1.1. Shoqëria **“Royal Qlt.” sh.p.k**, është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

- 2.1. Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
- 2.2. Shoqëria **“Royal Qlt.” sh.p.k**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortakët e shoqërisë”, të cilët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributet e ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.
- 2.3. Ortakët gëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kanë dhënë në kapital.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

3.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

**Neni 4**

**Selia**

- 4.1. Shoqëria e ka selinë kryesore në Njësinë Administrative Nr.3, Rruga “Sitki Çiço”, Pallati nr.12/1, Tiranë, zona kadastrale nr.8140.
- 4.2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.





## Neni 5

### Objekti i veprimtarisë

5.1. Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në përputhje me legjislacionin shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht, në:

- a) Ndërtim, restaurim, mirëmbajtje, kontrollimin, menaxhimin e objekteve civile, industriale, turistike, bujqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërtimin e rrugëve, autostradave, shkollave civile dhe ekonomike, asfaltim rrugësh, punime mirëmbajtjeje, mbikëqyrje, kolaudim, sinjalistikë etj. Ndërtimin, restaurim, mirëmbajtje, kontrollimin, menaxhimin i objekteve private dhe publike, duke përfshirë të gjitha llojet e punimeve të ndërtimeve, projektme, instalime, gërmime dheu etj. Ndërtim, ujësjellës-kanalizime, kanale, impiante vaditëse. Përforsime themeli e punime nëntokësore. Izolime mbi dhe nëntokësore nga ujerat. Ndërtim rrugësh dhe urash si dhe ndërtime portuale, detare dhe ajrore si dhe rikonstruksionin e tyre, asfaltim dhe veshje me asfaltim, ndërtim digash, galeri, tunele, ndërtimi i veprave të kullimit, ujitje, impiante vaditëse, punime mbrojtje dhe sisteme hidraulike, punime dhe sisteme elektrike. Ndërtim ambiente dhe sistemim gjelbërimi, parqe e lulishte, si dhe çdo ndërtim të llojeve të ndryshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- b) Prodhim, tregtimi import-eksport dhe shitje me shumicë dhe pakicë e materialeve të ndërtimit dhe mallrave të ndryshëm industrialë. Prodhim dhe tregtim të fidaneve dhe farave bujqësore në Republikën e Shqipërisë. Grumbullim dhe transportim mbetje jo të rrezikshme. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme. Shërbime të ndryshme në sferën e ndërtimit, si punë karpentierie, shtrime pllakash e parketesh, muratorë, hekurkthyes, punime elektrike, hidraulike, gipsi, etj., prodhim-zhvillim, import export dhe tregti të pajisjeve dhe programeve në fushën e teknologjisë së Informacionit. Konsulenca dhe mirëmbajtjeve të tyre. Krijim, organizim kurse profesionale, trajnime etj. Operim, zbatim, dhenie me qera e sistemeve dhe e pajisjeve të ndryshme informatike që shërbejnë për administrimin e operacioneve të ndërmarrjeve, shitje në internet, sisteme të parkimit, sisteme biletarie elektronike dhe të ngjashme. Tregtim me pakicë e shumicë të artikujve industriale, veshje dhe import eksportin e tyre. Veprimtari prodhimi dhe tregtimi që lidhen me veprimtari mekanike, elektromekanike, elektronike, kimike, bujqësi, mobilim, turizëm, ndërtim, trajtim ujor, ekologji, sport dhe produkte të tjera të lidhura me to ose plotësuese, si dhe blerje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditimi dhe administrimi, si dhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, dege ndërmarrjesh, si edhe të këtë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri e në koncesione, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me objektin e vet, apo gjithësi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.
- c) Ofrimin e Konsulencës ligjore dhe juridike për çështje të ndryshme. Shërbime përfaqësimi ndaj shoqërive tregtare, individëve, tregtareve, qofshin këta vendas apo të huaj, ofrimin e shërbimeve të marketingut ndaj subjekteve të ndryshëm etj. Përfaqësime në organet e administratës publike, gjykatat e çdo niveli, gjykata arbitrazhi brenda dhe jashtë vendit, zyra noteriale, ente private. Konsulentë në fushën e ndërtimit, projektimit, ekonomisë etj.. Ofrimin e shërbimeve në fushën e turizmit, dhënie-marrje ambientesh me

qira. Bar-kafe, pastiçeri, restoran etj.. Organizimit e eventeve dhe festave të ndryshme si dasma, ditëlindje, konferenca, reklama, trajnime, realizime foto, video etj. Zhvillimin e aktiviteteve sportive, palestere, fitnes, spa, etj.

Vlerësimi i pasurive të paluajtshme të çdo lloji: truall, ndërtesa civile dhe industriale, toka bujqësore, ara, pyje, kullota, livadhe etj. Hartimin e raporteve të vlerësimit të pasurive të paluajtshme për Bankat e nivelit të dytë, Fonde Investimi, persona fizik dhe juridik. Vlerësimin e pasurive që përbëjnë vlerë financiare. Kryerja e operacioneve ekonomike e juridike, industriale, prodhuese, tregtare që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, brenda kuadrit të dispozitave ligjore për realizimin e çdo biznesi të përshtatshëm në arritjen e qëllimit të shoqërisë;

- d) Transport mallrash dhe njerëzish brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- e) Në përputhje me legjislacionin në fuqi, ofrimin e shërbimit për Ruajtjen e objekteve dhe institucioneve publike dhe private, sigurimin fizik, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të shtetësive vendas dhe të huaj, instalim dhe përdorim i sinjalistikës të radio alarmit dhe pajisjeve të tjera të vëzhgimit. Prodhim mirëmbajtje dhe tregtim i pajisjeve dhe lendeve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit. Projektim dhe instalim i kontrollit të aksesit dhe të sigurisë së lartë, integrim i sistemeve. Projektim, furnizim, instalim dhe mirëmbajtje e sistemeve për prodhimin e energjisë alternative (fotovoltaike, wind etj). Konsulencë dhe analize të sigurisë Projektim, furnizim, instalim dhe mirëmbajtja e sistemeve të inteligjencës. Projektim, zbatim dhe mirëmbajtje të sistemeve dhe monitorimi i sistemeve të shuarjes së zjarrit. Projektim dhe instalim i pajisjeve dhe impianteve elektrike e civile. Furnizim, instalim, mirëmbajtje i pajisjeve elektronike për përdorim detare. Furnizim, instalim dhe mirëmbajtje i pajisjeve të telekomunikacionit dhe radio ndërlihdhjes. Importe-eksporte dhe shitje, ndërtim dhe mirëmbajtje e avionëve dhe pjesëve të tyre, detektive dhe investigues privat. Qendër trajnimit privat për punonjësit e SHPSF dhe atyre që me ligj i njihet e drejta e trajnimit strukturat ligj zbatuese. Shërbime të ruajtjes, transportit e shoqërimit të vlerave monetare e sendeve të çmuara.

5.2. Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji, lidhur apo ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

## **KREU II KAPITALI**


### **Neni 6 Kapitali themeltar**

6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) lekë, i zotëruar nga ortakët si më poshtë:

**Z Geri Nano**, zotëruar i 1 kuote, që përfaqësojnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 10 000 lekë

6.2. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme.

6.3. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).



- 6.4. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat, që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

#### **Neni 7**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 7.1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.
- 7.2. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakëve me të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 7.3. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare e Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 8**

##### **Transferimi i kapitalit**

- 8.1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 8.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 9**

##### **Organi Vendimmarrës**

- 9.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 9.2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 9.3. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 9.4. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 9.5. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **Neni 10**

### **Administrimi**

- 10.1. Administrator i shoqërisë është **Z. Geri NANO**.
- 10.2. Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjecar me të drejtë ripërtëritje.
- 10.3. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë.
- 10.4. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

## **Neni 11**

### **Kompetencat**

- 11.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) Administratori ne respekt te dispozitave ligjore, mund te kryeje te gjitha operacionet qe do te jne te konsideruara nga administratori te nevojshme dhe te dobishmeper te arritur objektivat sociale aty perfshire leshimin e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave te trete.
  - h) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



- 11.2. Administratori është i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur:
- a) Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
  - b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
- 11.3. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.
- 11.4. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.
- 11.5. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.
- 11.6. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.
- 11.7. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## **Neni 12**

### **Viti Financiar**

- 12.1. Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

## **Neni 13**

### **Bilanci i shoqërisë dhe dividendet**

- 13.1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.
- 13.2. Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

## **Neni 14**

### **Ekspertët**

- 14.1. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 14.2. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për

nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

14.3. Të ardhurat neto ( Dividenti ) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi ortakëve të shoqërisë.

## **Neni 15**

### **Prishja e shoqërisë**

15.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- d) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- e) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- f) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- g) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

15.2 Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.


## **Neni 16**

16.1. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

16.2. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar.

16.3. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

16.4. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të



këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

16.5. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji.

16.6. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

16.7. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

16.8. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së e ortakeve dhe administratorit.

### **Neni 17**

#### **Të drejtat e detyrimet e likuiduesit**

17.1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

17.2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

17.3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

17.4. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

### **Neni 18**

#### **Përfundimi i likuidimit**

18.1. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit, për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

### **Neni 19**

#### **Bashkimi**

19.1. Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

- a) Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në

**Neni 19**  
**Bashkimi**

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:


- a) Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të këtij shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
- b) Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

**Neni 20**  
**Ndarja**

- 20.1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakëve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
- 20.2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve të ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ndryshuar me ligjin 129/2104.
- 20.3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
- 20.4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë:
  - a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
  - b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
  - c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar pa kryerjen e likuidimit.

**Neni 21**  
**Shndërrimi**

- 21.1. Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare.
- 21.2. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.





**Neni 22**  
**Baza Ligjore**

- 22.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 22.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 23**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


**Neni 24**  
**Dispozita përfundimtare**

Ky Statut i shoqërisë "**Royal Qlt.**" sh.p.k, u redaktua nga unë "ortakët themelues" në 4 kopje me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

**ORTAKËT E SHOQËRISË**

**"Royal Qlt." sh.p.k**

**GERI NANO**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Geri Nano', written over a horizontal line.